

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA FIER

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale, Neni 248 "Shpërdorimi detyrës" Neni 328 " Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve", Neni 328/a "Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike", Neni 329 "Kanosja e zgjedhësit".

KUNDER: [REDAKTUAR] administrator i Njësisë Administrative [REDAKTUAR]

DREJTUAR: PROKURORISË PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE FIER

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 , si dhe neneve 248 ,328 ,328/a dhe 329 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, dhe 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijëni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Ëdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.